



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës : KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: E premte, 21 nëntor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër sipas Rregullave 134(b), (d) dhe 159(6) dhe Çështje të Lidhura me Të

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21 dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 134, 135 dhe 159(6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 15 prill 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi njoftimin për mbylljen e paraqitjes së provave të saj.¹
2. Më 12 qershor 2025, Mbrojtja dorëzoi një mocion të përbashkët sipas rregullës 130 ("Mocioni sipas Rregullës 130").²
3. Më 2 korrik 2025, Trupi Gjykses lëshoi një vendim³ me të cilin miratoi pjesërisht kërkesën e Mbrojtjes për ndryshimin e afateve kohore për dorëzimin e listës së dëshmitarëve dhe të provave materiale dhe për mbajtjen e konferencës përgatitore për Mbrojtjen.⁴
4. Më 7 korrik 2025, ZPS-ja iu përgjigj mocionit sipas rregullës 130.⁵
5. Më 16 korrik 2025, Trupi Gjykses lëshoi vendimin në lidhje me mocionin sipas rregullës 130.⁶

¹ F03121/F03121, Prokurorja e Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë sipas Rregullës 129*, 15 prill 2025.

² F03256, Mbrojtja, *Mocion i Përbashkët i Mbrojtjes sipas Rregullës 130*, 12 qershor 2025, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale (versioni i redaktuar publik i parashtrimit u dorëzua më 22 gusht 2025, F03256/RED).

³ F03302, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afateve*, 2 korrik 2025, para. 18, 27(e).

⁴ F03258, Mbrojtja, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afateve*, 13 qershor 2025, para. 2.

⁵ F03314, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës sipas Rregullës 130*, me Shtojcën 1, konfidenciale, 7 korrik 2025.

⁶ Transkripti i seancës, 16 korrik 2025, f. 26190, rreshti 12 deri në f. 26195, rreshti 15.

6. Më 19 gusht 2025, Trupi Gjykses mbajti konferencën përgatitore për Mbrojtjen.⁷

7. Më 2 shtator 2025, Trupi Gjykses: (i) caktoi të premtën, 14 nëntor 2025, ose një javë pas përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit të fundit të Mbrojtjes, cilado të jetë data e më e hershme, si datë të synuar për mbylljen e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes së Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit" dhe "z. Thaçi") dhe Mbrojtjes së Jakup Krasniqit ("Mbrojtja e Krasniqi" dhe "z. Krasniqi"); dhe (ii) informoi palët se duhet të jenë të gatshme të dorëzojnë dosjet gjyqësore përfundimtare dhe Mbrojtjen e Viktimave se duhet të jetë e gatshme të dorëzojë deklaratën e pasojave të veprave penale të pretenduara mbi viktimat pjesëmarrëse në proces ("Deklarata e Pasojave"), jo më vonë se të hënë, 22 dhjetor 2025.⁸

8. Më 15 shtator 2025, Mbrojtja e Thaçit filloi paraqitjen e provave të saj⁹ gjatë së cilës rreth dhjetë ditë seanca dhe disa orë të planifikuara për paraqitjen e provave të Mbrojtjes nuk u përdorën për shkak të problemeve në lidhje me planifikimin e paraqitjes së dëshmitarëve dhe rivlerësimin e kohës së kërkuar për pyetje nga pala kundërshtare.

9. Më 13 tetor 2025, pas konsultimeve *inter partes* me palët dhe pjesëmarrësit, Mbrojtja e Thaçit: (i) kërkoi që dosjet gjyqësore përfundimtare të dorëzoheshin nga palët më 30 janar 2026, ose gjashtëdhjetë (60) ditë pas mbylljes së procedurës së paraqitjes së provave, në cilëndo datë të mëvonshme; dhe (ii) vuri në dukje se, ndonëse Mbrojtja e Viktimave nuk iu bashkua kërkesës, ajo nuk ishte kundër një propozimi të arsyeshëm për një afat të ri që nuk ndikon në kryerjen e shpejtë të këtij procesi.¹⁰

⁷ Transkripti i seancës, 19 gusht 2025, f. 26431-26474.

⁸ F03435, Trupi Gjykses, *Urdhër i Mëtejshëm për Planifikimin e Paraqitjes së Provave të Mbrojtjes*, ("Urdhri i 2 Shtatorit 2025"), 2 shtator 2025, para. 35(1) dhe (n).

⁹ Transkripti i seancës, 15 shtator 2025, f. 26478.

¹⁰ CRSPD922, *Mesazh elektronik i Mbrojtjes së Thaçit drejtuar Trupit Gjykses në Lidhje me Dosjet Përfundimtare* ("CRSPD922"), 13 tetor 2025, konfidencial.

10. Më 17 nëntor 2025, Mbrojtja, ZPS-ja, dhe Mbrojtja e Viktimave bashkërisht kërkuar shtimin e numrit të fjalëve për dosjet gjyqësore përfundimtare dhe Deklaratën e Pasojave.¹¹

11. Dëshmitari i fundit në listën e dëshmitarëve të Mbrojtjes së Thaçit dëshmoi në proces gjyqësor më 18 nëntor 2025.¹² Që nga mbyllja e paraqitjes së provave të ZPS-së më 15 prill 2025, Trupi Gjykses mbajti 21 ditë seanca, përfshirë konferenca mbi ecurinë e çështjes.

12. Më 19 nëntor 2025, Trupi Gjykses mbajti një konferencë mbi ecurinë e çështjes në lidhje me aspekte të administrimit të gjykimit ("konferenca mbi ecurinë e çështjes").¹³ Gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes, Trupi Gjykses informoi palët dhe pjesëmarrësit se do të lëshonte një urdhër për të caktuar afate dhe për t'u dhënë palëve dhe pjesëmarrësve udhëzime në lidhje me disa aspekte të diskutuara në seancë.¹⁴

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

13. Sipas neneve 21 dhe 40(2), trupi gjykses siguron që shqyrtimi gjyqësor të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe që procedurat të zhvillohen në pajtim me Rregulloren, në respekt të plotë të drejtave të akuzuarit dhe duke i kushtuar kujdesin e duhur mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve. Trupi gjykses mund të miratojë procedura dhe modalitete që janë të nevojshme për të lehtësuar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procedurave. Ai mund të japë udhëzime për zhvillimin e

¹¹ CRSPD945, Mesazh elektronik i Palëve dhe Pjesëmarrësve drejtuar Trupit Gjykses në lidhje me Marrëveshjen për Gjatësinë e Dosjeve Përfundimtare ("CRSPD945"), konfidencial.

¹² Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28323, rreshtat 16-20.

¹³ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28307 deri në f. 28356.

¹⁴ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28352, rreshti 2 deri në 9.

procedurave të drejta dhe të paanshme në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe të Provave.

14. Sipas rregullës 116(1), trupi gjykues merr vazhdimisht të gjitha masat dhe miraton procedurat e nevojshme për lehtësimin e kryerjes së drejtë e të shpejtë të gjykimit. Pas këshillimit me palët, trupi gjykues përcakton një plan pune që përmban detyrimet e palëve dhe cakton afatet për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

III. DISKUTIM

A. ZHDËMTIMET

15. Trupi Gjykues ka marrë parashtrime të shumta nga palët dhe pjesëmarrësit¹⁵ në lidhje me fazën e procesit të zhdëmtimit sipas urdhrit të 6 nëntorit 2025.¹⁶ Për t'i shqyrtuar si duhet këto parashtrime, Trupi Gjykues do të shtyjë për në një fazë të mëvonshme marrjen e vendimit mbi modalitetet e procesit të zhdëmtimit.

B. DORËZIMI I KËRKESAVE PËR PRANIMIN E PROVAVE DHE MBYLLJA E PARAQITJES SË PROVAVE TË MBROJTJES

16. Mbrojtja e Thaçit konfirmoi në konferencën mbi ecurinë e çështjes se, në varësi të vendimit që pritet mbi një mocion të Mbrojtjes së Thaçit sipas rregullës 153,¹⁷ Mbrojtja nuk ka dëshmitarë të tjerë për të thirrur.¹⁸ Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja

¹⁵ F03582, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Procesin e Zhdëmtimit*, 17 nëntor 2026, konfidencial; F03583, Mbrojtja e Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtjes së Viktimave në Përgjigje ndaj Urdhrit për Parashtrime në lidhje me Procesin e Zhdëmtimit (F03565)*, 17 nëntor 2025, konfidencial; F03584, Mbrojtja, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Urdhrit për Parashtrime në lidhje me Procesin e Zhdëmtimit*, 17 nëntor 2025, konfidenciale. *Shih gjithashtu* Transkriptin e seancës, 19 nëntor 2025, f. 28311, rreshti 21 deri në f. 28322, rreshti 25.

¹⁶ F03565, Trupi Gjykues, *Urdhër për Parashtrime në lidhje me Procesin e Zhdëmtimit* ("Urdhri i 6 Nëntorit 2025") 6 nëntor 2025, konfidencial.

¹⁷ F03576, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me W04752-shin* ("Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit e 13 Nëntorit 2025"), 13 nëntor 2025.

¹⁸ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28323, rreshtat 16-20.

e Krasniqit bënë me dije gjithashtu se, nëse pas rishikimit të listave të tyre përkatëse të provave materiale do të kenë ndonjë kërkesë për pranim provash të tjera, dy ekipet e Mbrojtjes do të jenë në gjendje t'i dorëzojnë këto mocione deri të mërkurën, 26 nëntor 2025.¹⁹ Mbrojtja e Thaçit bëri me dije gjithashtu se do të jetë në gjendje të mbyllë paraqitjen e provave të saj sipas rregullës 131 pas vendimit mbi kërkesën e saj për pranim të provave sipas rregullës 153,²⁰ dhe Mbrojtja e Krasniqit bëri me dije se mund të mbyllë paraqitjen e provave të saj të mërkurën, 26 nëntor 2025.²¹

17. Pasi dëgjoi argumentet lidhur me këtë pikë, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Thaçit dhe Mbrojtjen e Krasniqit të bëjnë rishikimin përfundimtar të dokumentacionit të tyre dhe të dorëzojnë ndonjë kërkesë që mund të kenë për pranim provash deri **të mërkurën, 26 nëntor 2025**.

18. Trupi Gjykses urdhëron gjithashtu Mbrojtjen e Thaçit dhe Mbrojtjen e Krasniqit të dorëzojnë njoftim lidhur me mbylljen e paraqitjes së provave të tyre përkatëse sipas rregullës 131, deri **të martën, 2 dhjetor 2025**, ose ditën e parë të punës pas lëshimit të vendimit të fundit të Trupit Gjykses mbi kërkesën për pranimin e provave, cilado datë të jetë më e hershme.

C. DORËZIMI I MOCIONEVE PËR PARAQITJE KUNDËRPROVASH

19. Trupi Gjykses vë në dukje se sipas rregullës 133, pas mbylljes së paraqitjes së provave të Mbrojtjes ose pasi të jenë dëgjuar dëshmitë e thirrura nga trupi gjykses, kryegjykatësi i trupit gjykses i pyet palët nëse kanë mocione për paraqitje kundërprovash sipas rregullës 127.

¹⁹ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28323, rreshti 21 deri në f. 28324, rreshti 23.

²⁰ *Shih më lart*, poshtëshënimin 17.

²¹ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28325, rreshtat 15-16.

20. Trupi Gjykses rikujton se në seancën mbi ecurinë e çështjes informoi palët dhe pjesëmarrësit se synonte të jepte vendim mbi të gjitha kërkesat e paraqitura për pranim të provave deri më 1 dhjetor 2025²² dhe kujtoi gjithashtu se palët nuk synonin të paraqisnin prova sipas rregullës 132.²³

21. Në konferencën mbi ecurinë e çështjes, ZPS-ja informoi se nuk ka marrë ende vendim përfundimtar lidhur me dorëzimin e një mocioni për paraqitje kundërprovash.²⁴ Megjithatë, ZPS-ja parashtrroi gjithashtu se parashikon të jetë gati të dorëzojë ndonjë mocion të mundshëm për paraqitje kundërprovash, ose të njoftojë Trupin Gjykses për të kundërtën, brenda një jave nga vendimi përfundimtar mbi pranimin e provave.²⁵

22. Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmitari i fundit i Mbrojtjes së Thaçit dëshmoi më 18 nëntor 2025.²⁶ Po ashtu, ka një numër të vogël kërkesash për pranim provash për të cilat ende nuk është dhënë vendim. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se rregulla 133 përcakton se mocionet për paraqitje kundërprovash miratohen vetëm "në raste të jashtëzakonshme", dhe se për to zbatohen edhe kushte të tjera.²⁷ Rrjedhimisht, ZPS-ja duhet të jetë në gjendje të vlerësojë menjëherë nëse është e përshtatshme të dorëzohet mocion për paraqitje kundërprovash. Duke mbajtur parasysh sa më lart dhe pasi ka dëgjuar parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve lidhur me këtë pikë, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në të dorëzojë mocionet e mundshme për paraqitje kundërprovash, ose të njoftojë se nuk synon të dorëzojë të tilla, brenda dy ditësh pune nga lëshimi i vendimit të fundit të Trupit Gjykses mbi kërkesat për pranim provash për të cilat ende nuk është dhënë vendim.

²² Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28329, rreshtat 24-25.

²³ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28327, rreshtat 22-23.

²⁴ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28328, rreshtat 5-19.

²⁵ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28328, rreshtat 20-23.

²⁶ *Shih më lart*, poshtëshënimin 12.

²⁷ *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-05, F00424, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorisë për Paraqitje të Kundërprovave*, 27 maj 2022, konfidencial, para. 9.

D. GJATËSIA E DOSJEVE GJYQËSORE PËRFUNDIMTARE

23. Trupi Gjykues vë në dukje se më 17 nëntor 2025, palët dhe pjesëmarrësit kërkuar shtim të numrit të fjalëve për dosjet gjyqësore përfundimtare dhe deklaratën e pasojave të Mbrojtjes së Viktimave.²⁸ ZPS-ja kërkoi 180.000 fjalë dhe ekipet e Mbrojtjes kërkuar përkatësisht nga 90.000 fjalë për dosjet gjyqësore përfundimtare. Mbrojtja e Viktimave kërkon 90.000 fjalë për deklaratën e pasojave.²⁹

24. Trupi Gjykues vëren se sipas nenit 45 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara, dosja gjyqësore përfundimtare nuk duhet të jetë më shumë se 30.000 fjalë. Në gjykimet me disa të akuzuar dhe nëse Trupi Gjykues nuk ka urdhëruar ndryshe, ZPS-ja parashtron një dosje të përbashkët gjyqësore përfundimtare me jo më shumë se 20.000 fjalë për rrethanat kontekstuale dhe jo më shumë se nga 15.000 fjalë për çdo të akuzuar dhe deklarata e pasojave e Mbrojtjes së Viktimave nuk duhet të jetë më shumë se 20.000 fjalë.³⁰ Megjithatë, Trupi Gjykues vë në dukje se krimet e paraqitura në Aktakuzë dhe provat në këtë proces gjyqësor trajtojnë aspekte komplekse që përfshijnë një numër vendndodhjesh të pretenduara të krimeve. Krahas kësaj, në këtë proces gjyqësor janë rreth 155 viktima pjesëmarrëse. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues, duke ushtruar diskrecionin e vet, konstaton se ka arsye të vlefshme për shtimin e numrit të fjalëve për dosjet gjyqësore përfundimtare dhe deklaratën e pasojave si më poshtë:
(i) ZPS-së i miratohen 180.000 fjalë gjithsej për dosjen gjyqësore përfundimtare;
(ii) secilit ekip të Mbrojtjes i miratohen 90.000 fjalë gjithsej për dosjen e vet

²⁸CRSPD945.

²⁹CRSPD945. *Shih gjithashtu* Transkriptin e seancës, 19 nëntor 2025, f. 28340, rreshti 9 deri në f. 28341, rreshti 23.

³⁰ KSC-BD-15, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019 (“Udhëzuesi i Punës për Parashtrimet e Protokolluara”).

gjqësore përfundimtare; dhe (iii) Mbrojtjes së Viktimave i miratohen 90.000 fjalë për deklaratën e pasojave.

25. Trupi Gjykues përsërit se dosjet gjyqësore përfundimtare të palëve duhet të përqendrohen në aspekte faktike thelbësore për të cilat ka mospajtim mes palëve dhe të trajtojnë provat relevante dhe juridikisht thelbësore për këto aspekte. Ato duhet të trajtojnë gjithashtu pikat ligjore për të cilat palët nuk pajtohen. Dosjet gjyqësore përfundimtare nuk duhet të përmbajnë diskutime për pika të pakundërshtuara ose jorelevante, si për shembull rrethanat historike ose kontekstuale që nuk lidhen me akuzat, siç janë krimet serbe pa lidhje të vërtetueshme me akuzat në këtë çështje gjyqësore, diskutime të aspekteve për të cilat tashmë është marrë vendim, argumente përsëritëse, dhe historik procedural panevojshmërisht të gjatë. Dosjet gjyqësore përfundimtare të palëve nuk duhet të trajtojnë aspekte që kanë të bëjnë me zhdëmtime të mundshme. Gjithashtu, Trupi Gjykues nxit palët të përfshihen në diskutime *inter partes* për identifikimin e pikave për të cilat nuk pajtohen.

E. DATA E DORËZIMIT TË DOSJEVE GJYQËSORE PËRFUNDIMTARE

26. Trupi Gjykues rikujton se, në Urdhrin e 2 Shtatorit 2025, informoi palët dhe pjesëmarrësit se duhet të ishin të gatshëm të dorëzonin dosjet gjyqësore përfundimtare dhe deklaratën e pasojave përpara fillimit të pushimit dimëror të Gjykatës, **të hënën, 22 dhjetor 2025.**³¹

27. Më 13 tetor 2025, palët dhe pjesëmarrësit kërkuan që dosjet gjyqësore përfundimtare të palëve dhe deklarata e pasojave e Mbrojtjes së Viktimave të dorëzohen më 30 janar 2026, ose gjashtëdhjetë (60) ditë pas mbylljes së paraqitjes së provave, cilado datë të jetë e mëvonshme.³² ZPS-ja parashtroi ndër të tjera se dosjet gjyqësore përfundimtare janë një fazë e rëndësishme e gjykimit, sidomos

³¹ Urdhri i 2 Shtatorit 2025, para. 34, 35(n).

³²CRSPD922. *Shih gjithashtu* Transkriptin e seancës, 19 nëntor 2025, f. 28333, rreshtat 4-7.

duke pasur parasysh vëllimin dhe kompleksitetin e kësaj çështjeje, dhe u mundësojnë palëve mund të bëjnë parashtrime lidhur me peshën përfundimtare të provave të paraqitura në gjykim, si edhe të paraqesin argumentet përkatëse mbështetur në tërësinë e provave të administruara.³³ Në lidhje me këtë, ZPS-ja parashtroi gjithashtu se provat në tërësi nuk mund të vlerësohen siç duhet dhe të merren vendime përfundimtare për to pa përfunduar paraqitja e tyre.³⁴

28. Mbrojtja e Thaçit parashtroi se ka punuar me intensitet për përgatitjen e mbrojtjes dhe, për pasojë, nuk ka burime të mjaftueshme për ta ndihmuar z. Thaçi të vlerësojë 25.865 faqe transkripti dhe mijëra prova që janë pranuar.³⁵ Ekipet e tjera të Mbrojtjes mbështetën parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit³⁶ dhe Mbrojtja e Viktimave nuk kundërshtoi datën e kërkuar për dorëzimin e dosjeve gjyqësore përfundimtare dhe të deklaratës së pasojave.³⁷

29. Trupi Gjykses vëren se dëshmitari i fundit i ZPS-së dëshmoi më 27 mars 2025³⁸ dhe ZPS-ja mbylli paraqitjen e provave më 15 prill 2025.³⁹ Mbrojtja dorëzoi Mocionin e Përbashkët sipas Rregullës 130 më 12 qershor 2025⁴⁰ dhe ZPS-ja u përgjigj më 7 korrik 2025.⁴¹ Më 16 korrik 2025, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin mbi Mocionin sipas Rregullës 130.⁴² Dy dëshmitarë ekspertë të thirrur nga Mbrojtja e Viktimave dëshmuan më 16 dhe 17 korrik 2025.⁴³ Paraqitja e provave të Mbrojtjes filloi më 15 shtator 2025⁴⁴ dhe në tërësi zgjati rreth 14 ditë seanca, me ndërprerje

³³ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28333, rreshtat 8-15, dhe f. 28334, rreshtat 8-16 dhe f. 28335, rreshtat 9-16.

³⁴ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28333, rreshtat 20-22.

³⁵ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28336, rreshti 13 deri në f. 28337, rreshti 3.

³⁶ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28337, rreshti 12 deri në f. 28339, rreshti 7.

³⁷ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28339, rreshtat 11-13.

³⁸ Transkripti i seancës, 27 mars 2025, f. 26036, rreshti 10.

³⁹ *Shih më lart*, poshtëshënimin 1.

⁴⁰ *Shih më lart*, poshtëshënimin 2.

⁴¹ *Shih më lart*, poshtëshënimin 4.

⁴² *Shih më lart*, poshtëshënimin 5.

⁴³ Transkripti i seancës, 16 korrik 2025, f. 26206, rreshti 24 deri në f. 26315, rreshti 4. Transkripti i seancës, 17 korrik 2025, f. 26320, rreshti 12 deri në f. 26367, rreshti 14.

⁴⁴ Transkripti i seancës, 15 shtator 2025, f. 26477, rreshti 24.

mes dëshmive të dëshmitarëve. Siç u vu në dukje më lart, kanë kaluar shtatë muaj nga mbyllja e provave të ZPS-së dhe dëshmisë së dëshmitarit të fundit të Mbrojtjes. Mbrojtja e Thaçit thirri shtatë dëshmitarë, Mbrojtja e Krasniqit nuk pati dëshmitarë në sallën e gjyqit apo sipas rregullës 154, dhe dy ekipet e tjera të Mbrojtjes nuk paraqitën prova. Në konferencën mbi ecurinë e çështjes, palët dhe pjesëmarrësit konfirmuan se, në kuadër të përmbushjes me rigorozytet të përgjegjësisë të tyre, kanë kohë që po punojnë për përgatitjen e dosjeve gjyqësore përfundimtare.⁴⁵

30. Trupi Gjykses është i vetëdijshëm që ky proces gjyqësor është kompleks, me prova që kanë të bëjnë me shumë vendngjarje krimesh dhe me disa forma të përgjegjësisë penale. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se, që nga mbyllja e paraqitjes së provave të ZPS-së deri në dhënien e dëshmisë nga dëshmitari i fundit i Mbrojtjes, palët dhe pjesëmarrësit kanë pasur kohë të bollshme për të ekzaminuar provat materiale, për të vlerësuar peshën e tyre, si dhe për të konsoliduar argumentet e tyre dhe për të përparuar ndjeshëm me përpilimin e dosjeve gjyqësore përfundimtare. Trupi Gjykses vë në dukje në veçanti se Mbrojtja pati mundësinë t'i ekzaminonte provat materiale për përgatitjen e Mocionit sipas Rregullës 130 dhe bëri parashtrime në atë fazë të procesit se duhej t'i jepej kohë e mjaftueshme për ta bërë atë ekzaminim.⁴⁶ Trupi Gjykses miratoi kohë shtesë bazuar në ato parashtrime.⁴⁷ Provat materiale të pranuar nuk janë të panjohura për palët dhe vetëm për një numër krahasimisht të vogël pritët vendim në lidhje me pranimin e tyre. Shumica e materialit provues ka mjaft kohë që është pjesë e dokumentacionit të çështjes dhe pjesa më e madhe e tij ka qenë e njohur për palët për një kohë të konsiderueshme.

⁴⁵ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28343, rreshti 16 deri në f. 28346, rreshti 1.

⁴⁶ Transkripti i seancës, 22 janar 2025, f. 24341, rreshtat 1-7.

⁴⁷ Transkripti i seancës, 23 prill 2025, f. 26176, rreshtat 8-14 *Shih gjithashtu* F03216, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Materialeve në lidhje me Pengimin*, 29 maj 2025, konfidencial, para. 70.

31. Bazuar në këtë, dhe duke pasur parasysh parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve, Trupi Gjykses e kupton se afati aktual për dorëzimin e dosjeve gjyqësore përfundimtare, 22 dhjetor 2025, mund të mos jetë i mjaftueshëm që palët dhe pjesëmarrësit të përfshijnë në tërësi provat e paraqitura nga ekipet e Mbrojtjes dhe të bëjnë parashtrime në lidhje me to, dhe të vlerësojnë tërësinë e këtyre provave. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i gatshëm ta miratojë pjesërisht kërkesën, ndryshon afatin e mëparshëm, dhe urdhëron palët dhe pjesëmarrësit të dorëzojnë dosjet gjyqësore përfundimtare dhe deklaratën e pasojave të **hënën, 19 janar 2026**.

F. CAKTIMI I SEANCËS PËR DEKLARATAT PËRMBYLLËSE

32. Trupi Gjykses vëren se, në pajtim me rregullën 134(d), Trupi Gjykses do të caktojë një seancë për deklaratat përmbyllëse që do të paraqiten brenda njëzet e një (21) ditësh nga dorëzimi i dosjeve gjyqësore përfundimtare dhe deklaratës së pasojave.

33. Gjatë konferencë mbi ecurinë e çështjes, ZPS-ja parashtroi se duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes dhe faktin se nuk do të ketë përgjigje me shkrim ndaj dosjeve gjyqësore përfundimtare, afati dyzet e pesë (45) ditësh nga dorëzimi i dosjeve gjyqësore mund të jetë i përshtatshëm.⁴⁸ Mbrojtja e Viktimave e mbështeti propozimin e ZPS-së.⁴⁹ Mbrojtja deklaroi se në qoftë se miratohet zgjatja e afatit për dorëzimin e dosjeve gjyqësore përfundimtare, asaj do t' i duhet kohë e mjaftueshme për të analizuar dosjen gjyqësore përfundimtare të ZPS-së.⁵⁰ Gjithashtu, ZPS-ja deklaroi se do t' i duhen dy ditë seanca të plota⁵¹ dhe ekipet e

⁴⁸ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28346, rreshti 23 deri në f. 28347, rreshti 18.

⁴⁹ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28347, rreshti 21.

⁵⁰ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28347, rreshti 23 deri në f. 28348, rreshti 4 dhe f. 28351, rreshtat 1-10, 16-18, dhe rreshtat 21-23.

⁵¹ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28348, rreshtat 9-18.

Mbrojtjes deklaruan se do t'u duhet një ditë e plotë secilit për të paraqitur parashtrimet e tyre përmbyllëse.⁵²

34. Pasi dëgjoi parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve, dhe duke pasur parasysh vendimin e vet se palët dhe Mbrojtja e Viktimave duhet të dorëzojnë dosjet gjyqësore përfundimtare dhe deklaratën e pasojave jo më vonë se 19 janari 2026,⁵³ Trupi Gjykses informon palët dhe pjesëmarrësit se synon të mbajë seancat për deklaratat përmbyllëse më **9-13 shkurt 2026**. Trupi Gjykses thekson se do të lëshojë një urdhër tjetër lidhur me mbajtjen e seancave në të cilin do të përcaktohen më saktë modalitetet e paraqitjes së deklaratave përmbyllëse të palëve dhe pjesëmarrësve. Mundësia e ditëve shtesë për parashtrimet përfundimtare do të shqyrtohet në atë fazë, në momentin që Trupi Gjykses do të jetë në gjendje t'u japë palëve dhe pjesëmarrësve më shumë hollësi për orarin dhe kohën që i është caktuar secilit prej tyre për paraqitjen e parashtrimeve përfundimtare.

G. KËRKESA E MBROJTJES PËR PROCES MË VETE PËR PËRCAKTIMIN E DËNIMIT

35. Mbrojtja kërkoi që Trupi Gjykses të mbajë një proces më vite për përcaktimin e dënimit sipas rregullave 162 dhe 164, që, sipas Mbrojtjes, është në përputhje me të drejtat e të akuzuarve për gjykim të drejtë dhe të shpejtë dhe në interes të efikasitetit gjyqësor.⁵⁴ Sipas Mbrojtjes, të akuzuarit duhet të kenë të drejtën të bëjnë parashtrime konkrete dhe specifike në lidhje me përcaktimin e dënimit pas marrjes së njoftimit të shpalljes së fajësisë⁵⁵ pasi në të kundërt parashtrime të tilla do të

⁵² Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28348, rreshtat 5-6, dhe f. 28351, rreshtat 10-11 dhe rreshtat 18-19 dhe rreshti 25.

⁵³ Shih më lart, para. 31.

⁵⁴ F03584, Mbrojtja, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Urdhrit për Parashtrime në lidhje me Procesin e Zhdëmtimit*, ("Kërkesa lidhur me Përcaktimin e Dënimit") 17 nëntor 2025, konfidenciale, para. 12. Shih gjithashtu Transkriptin e seancës, 19 nëntor 2025, f. 28353, rreshti 20 deri në f. 28354, rreshti 4.

⁵⁵ Kërkesa lidhur me Përcaktimin e Dënimit, para. 14.

bëheshin në vakum⁵⁶ dhe të akuzuarit nuk mund të bëjnë parashtrime të njëmendta lidhur me peshën e pretendimeve pa pasur vendimin e Trupit Gjykses në lidhje me faktet dhe krimet e vërtetuara.⁵⁷ Gjithashtu, Mbrojtja argumenton se ka të drejtën të paraqesë prova relevante për përcaktimin e dënimit dhe se duhet ti jepet koha dhe mundësia për ta bërë këtë.⁵⁸

36. ZPS-ja u përgjigj se jurisprudenca e mëhershme e Dhomave të Specializuara e bën të qartë se përcaktimi i dënimit trajtohet zakonisht në aktgjykim, siç përcaktohet në rregullën 159(6), dhe nuk ka arsye që në këtë çështje përcaktimi i dënimit të mos trajtohet në aktgjykim.⁵⁹

37. Trupi Gjykses vë në dukje se rregulla 159(6) parasheh procedurën më vete për përcaktimin e dënimit vetëm si mundësi dytësore, "përveçse, pasi të ketë dëgjuar palët, trupi gjykses vendos të procedojë" në atë mënyrë. Rregulla 159(6) e bën të qartë se ekziston prezumimi se trupi gjykses përcakton dënimin e duhur në të njëjtën kohë me shpalljen e aktgjykimit. Rrjedhimisht, në kuadër të përmbushjes me rigorozitet të përgjegjësive të tyre, Mbrojtja dhe palët duhet të kenë planifikuar dhe paraqitur në gjykim të gjitha provat që sipas tyre janë relevante për përcaktimin e dënimit.⁶⁰

38. Trupi Gjykses nuk mendon se Mbrojtja ka provuar se rrethanat e kësaj çështje përlligjin shmangie nga prezumimi i përcaktuar në rregullën 159(6). Sipas praktikës së ndjekur në këtë Gjykatë, në rast të shpalljes së fajësisë, Trupi Gjykses ka ndër mend të caktojë dënimin e mundshëm bashkë me shpalljen e aktgjykimit dhe aktualisht nuk ka ndërmend të zbatojë procedurën e përcaktuar në rregullat 162 dhe 164 të Rregullores. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses hedh poshtë propozimin e Mbrojtjes që dënimi të shqyrtohet në një fazë të mëvonshme dhe urdhëron palët

⁵⁶ Kërkesa lidhur me Përcaktimin e Dënimit, para. 13.

⁵⁷ Kërkesa lidhur me Përcaktimin e Dënimit, para. 12.

⁵⁸ Kërkesa lidhur me Përcaktimin e Dënimit, para. 17.

⁵⁹ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28354, rreshti 15 deri në f. 28355, rreshti 7.

⁶⁰ KSC-BC-2020-07, F00553, Trupi Gjykses II, *Vendim për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave dhe për Parashtrime sipas Rregullave 134(b), (d) dhe 159(6) të Rregullores*, 3 shkurt 2022, publik, para. 16.

që parashtrimet që dëshirojnë të bëjnë në lidhje me përcaktimin e dënimit t'i përfshijnë në dosjet gjyqësore përfundimtare.

IV. VENDIM

39. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues:

- a) **SHTYN** për më vonë marrjen e vendimit në lidhje me modalitetet e procesit të zhdëmtimit;
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen e Thaçit dhe Mbrojtjen e Krasniqit të dorëzojnë kërkesat e mundshme për pranim të provave deri **të mërkurën, 26 nëntor 2025**;
- c) **URDHËRON** Mbrojtjen e Thaçit dhe Mbrojtjen e Krasniqit të dorëzojnë njoftim lidhur me mbylljen e paraqitjes së provave të tyre përkatëse sipas rregullës 131 deri **të martën, 2 dhjetor 2025**, ose deri ditën e parë të punës pas nxjerrjes së vendimit të fundit të Trupit Gjykues mbi kërkesën për pranimin e provave, cilado të jetë data e mëhershme;
- d) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë mocion për paraqitje kundërprovash, ose njoftim se nuk ka të tillë, dy ditë pune pas nxjerrjes së vendimit të fundit të Trupit Gjykues mbi kërkesat për pranim të provave për të cilat ende nuk është dhënë vendim;
- e) **MIRATON** kërkesën për shtimin e numrit të fjalëve për dosjet gjyqësore përfundimtare të palëve dhe për deklaratën e pasojave të Mbrojtjes së Viktimave siç përcaktohet në paragrafin 24 më lart, dhe **FTON** palët dhe pjesëmarrësit të shqyrtojnë me kujdes udhëzimet e Trupit Gjykues lidhur me përmbajtjen e dosjeve gjyqësore përfundimtare, të përcaktuara në paragrafin 25 më lart;
- f) **URDHËRON** palët të dorëzojnë dosjet gjyqësore përfundimtare dhe

Mbrojtjen e Viktimave të dorëzojë deklaratën e pasojave deri **të hënën, 19 janar 2026;**

- g) **INFORMON** palët dhe pjesëmarrësit se deklaratat përmbyllëse do të paraqiten prej datës **9 deri më 13 shkurt 2026;** dhe
- h) **RRËZON** kërkesën lidhur me përcaktimin e dënimit dhe **URDHËRON** palët që parashtrimet në lidhje me përcaktimin e dënimit t'i bëjnë në dosjet gjyqësore. përfundimtare.

/nënshkrim/

Gjykatësi Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 21 nëntor 2025

Në Hagë, Holandë